

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për Bletarinë”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Zhvillim
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Ka përafrim me legjislacionin e BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Ka përafrim me legjislacionin e BE-së, me Rregulloret BE: nr.1308/2013 datë 17 dhjetor 2013, “Për Organizimin e tregut të Përbashkët”; nr. 429/2016 datë 9 mars 2016 “Për sëmundjet e tranmetueshme lidhur me shëndetin e kafshëve”; nr. 1/2005 datë 22 dhjetor 2004 “Për mbrojtjen e kafshëve gjatë transportit..”;
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.709, datë 29.10.2014 “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020”; Draft strategjia “Për bujqësinë, zhvillimin rural dhe peshkimin 2021-2027; Strategjia e Mbrojtjes së Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjes së Tregut 2020, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 753, datë 16.9.2015, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2015 - 2020”
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	30.03.2022
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT? NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	Jo
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2022– MBZHR- Nr.2
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Julinda Bare <i>e-mail-i:</i> julinda.bare@bujqesia.gov.al Entela Kola <i>e-mail-i:</i> entela.kola@bujqesia.gov.al Glaudiana Musaj <i>e-maili:</i> glaudiana.musaj@bujqesia.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

(Maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Pse është e nevojshme ndërhyrja e qeverisë?

Bletaria është sektor i rëndësishëm i bujqësisë së vendit që shërben si burim prodhimesh natyrale me vlerë të lartë ushqimore dhe mjekësore. Përmes pjalmimit ose polenizimit ndikon në rritjen e prodhimit të shumë kulturave bujqësore, ndikon në mbajtjen e florës së pyjeve dhe kullotave duke ripërtërirë natyrën si hallkë e zinxhirit ekologjik, mbështet dhe ofron shërbime të tjera, të tilla, si: apiturizmi (turizmi i bletëve), apiterapia (përdorimi mjekësor i produkteve nga bletët) dhe monitorimi i ndotjes së mjedisit.

Nisur nga kjo rëndësi, kërkesat për përafrimin me legjislacionin e BE-së si dhe bazuar në faktin që nuk ka legjislacion të veçantë për këtë veprimtari, është i domosdoshëm hartimi i një ligji për Bletarinë.

Përafrimi rregullore të BE-së, mungesa e një legjislacioni të vetëm për CMO (Organizimi i tregut të Përbashkët), pjesë e së cilës është dhe bletaria, bën të domosdoshme hartimin e një ligji të ri.

Bletaria karakterizohet nga shumëllojshmëria e kushteve dhe rendimenteve të prodhimit dhe shpërndarja dhe shumëllojshmëria e operatorëve ekonomikë, si në fazën e prodhimit ashtu edhe në atë të tregtimit. Për të përmirësuar prodhimin dhe tregtimin e produkteve të bletarisë, si dhe duke pasur parasysh rritjen e incidencës në shëndetin e bletëve të llojeve të caktuara të pushtimeve të koshereve, dhe në veçanti të përhapjes së varrozës në vende të ndryshme të BE-së dhe jo vetëm, vitet e fundit dhe problemeve që kjo sëmundje shkakton në prodhimin e mjaltit, lind nevoja e trajtimit dhe kontrollit.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

- Përcaktimi i rregullave për prodhimin, regjistrimin, transportin, riprodhimin, mbrojtjen, etiketimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve të bletarisë, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe gjurmueshmërinë e këtyre produkteve sipas programeve 3 vjeçare.
- Hartimi i Programit për Bashkërendimin e Aktiviteteve për Sektorin e Bletarisë, në bashkëpunim me Shoqatat e Bujqësisë, Shoqatat e Bletërritësve në nivel lokal dhe Federatën e Bletërritësve në nivel kombëtar.
- Mbështetja e Sektorit të Bletarisë në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së produkteve shqiptare të bletarisë si dhe nxitja e proceseve të gjurmueshmërisë sipas legjislacionit përkatës, për mbrojtjen e mjaltit shqiptar.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave të politikës janë shqyrtuar opsionet e mëposhtme:

- Opsioni 0 (*status quo*): Ky opsion do të thotë të vijohet të mbeten problematikat aktuale duke mos adresuar zgjidhjen e tyre. Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re, duke mos hartuar ligjin për rregullimin e veprimtarisë së bletarisë. Mos ndërhyrja dhe ruajtja e status quo-së, do të çojë në mos zgjidhjen e problemeve të hasura aktualisht.
- Opsioni 1: Hartimi i një ligji “Për bletarinë”, për të mundësuar rregullimin ligjor të kësaj veprimtarie, i cili është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Ndikimet ekonomike të opsionit të preferuar do të përfshijnë kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik. Për këtë projektligj nuk identifikohen kosto që ngarkojnë buxhetin e shtetit.

Do të ketë gjithashtu edhe *disa lloje ndikimesh jo të drejtpërdrejta ekonomike*, që janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejta në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve të bletarisë si rezultat i kontrollit gjatë të gjithë zinxhirit ushqimor, pasi një ushqim i sigurt garanton një jetë të shëndetshme e për rrjedhojë shpenzimet për kujdesin shëndetësor do të reduktohen.

Ndikimi mjedisor i drejtpërdrejtë.

Bletaria si veprimtari me interes kombëtar, është e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë në përgjithësi dhe synon garantimin e pjalmimit natyror të gjithë bimësisë. Meqenëse bletët pjallojnë mbi 80% të bimëve të lulëzuara të tokës, duke përfshirë pothuajse të gjitha frutat dhe perimet, duhet të ndërmerren hapa për të rritur ndërgjegjësimin për nevojën për të mbrojtur bletët pasi rënia e numrit të tyre mund të ketë një ndikim të paparashikueshëm në ekosistemet e tokës.

Ndikimi Social i drejtpërdrejtë.

Nëpërmjet këtij projektligji si mbështetje për bletarinë, parashikohen stimuj për të rinjtë për t'u vendosur dhe qëndruar në sektorin e bletarisë si dhe sigurimin e mbështetjes për bletarët që operojnë në zona malore ose në zona të pafavorizuara.

Ndikim *jo të drejtpërdrejtë* do të ketë edhe tek konsumatori, nëpërmjet produkteve të bletarisë më të sigurta, më cilësore dhe shkallë më të lartë gjurmueshmërie për to.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Analiza me shumë kritere e kryer për të dy opsionet tregoi se opsioni 1, hartimi i ligjit “Për bletarinë” është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar. Me opsionin e përzgjedhur do të bëhet i mundur finalizimi i kuadrit ligjor, lidhur me rregullat për prodhimin, regjistrimin, transportin, riprodhimin, mbrojtjen, etiketimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve të bletarisë, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe gjurmueshmërinë e këtyre produkteve.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare, menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?) çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyt pse?)

Më datë projektligji “Për bletarinë”, së bashku me relacion shpjegues dhe Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA) do të publikohen për konsultim publik në Regjistrin Elektronik të Konsultimit Publik në ëbsite <http://www.konsultimipublik.gov.al>.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?

Zbatimi dhe monitorimi do të realizohen, sipas përcaktimeve të dispozitave të projektligjit. Autoritetet përgjegjëse për çështjet e bletarisë janë:

- Struktura përgjegjëse për bletarinë në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR).
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU).
- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB).
- Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB).
- Shoqatat lokale të bletërritësve.

Struktura përgjegjëse për bletarinë në MBZHR, është përgjegjëse për hartimin e politikave, programeve dhe legjislacionit që lidhet me sektorin e bletarisë. Kjo strukturë do të krijojë dhe mbajë një regjistër për bletët, sipas përcaktimit të projektligjit. Do të koordinojë procesin me AKVMB-të, me shoqatat e bletërritësve, me Federatën, si dhe me strukturën përkatëse për të mundësuar gjurmueshmërinë e produkteve të bletëve.

AKU është është institucioni zyrtar për kryerjen e kontrolleve, sipas legjislacionit përkatës për këtë qëllim.

AKVMB, do të kryejë regjistrimin e koshereve (zgjojeve) në regjistrin RUDA, do të ndjekë

ecurinë, në zbatim të ligjit të veterinarisë, do të autorizojë pas marrjes së aprovimit nga shoqatat lokale të bletërritësve, shtegtimin e tyre, do të kontrollojë të dhënat lidhur me marrjen e mjekimeve të ndryshme, nëse ka, si dhe do të autorizojë dëshmipërblimet në rastet e fatkeqësive sipas përcaktimeve të ligjit “Për veterinarinë”

AREB Do të kryejnë regjitrin e bletërritësve në regjistrin e fermës dhe do të pajisin me NIPT aplikantin.

Shoqatat Lokale të Bletërritësve, do të mundësojnë trajnimet për bletarët e rinj, profesionistë dhe amatorë, do të japin aprovimin për shtegtim të bletëve, sipas përcaktimeve të ligjit, do të bashkëpunojnë ngushtësisht me AKVMB. Po ashtu do të bashkëpunojnë më strukturën përgjegjëse për hartimin e planeve si dhe shfrytëzimin e kullotave. Do të ndjekin nga afër problematikat e bletërritësve dhe do të adresojnë ato.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

• Jepni kontekstin e politikës

Aktualisht nuk kemi një ligj të dedikuar për bletarinë. Ky sektor është prekur në legjislacionin e blegtorisë, atë të veterinarisë, të sigurisë ushqimore, por që bën të pamundur leximin dhe zbatueshmërinë nga ana e bletërritësve. Ka qenë një kërkesë e shoqatave të bletërritësve, për arësye se, Bleta është e rëndësishme pasi:

- Bazohet mbijetesa e shumicës së bimëve;
- Me ndihmën e saj rriten rendimentet në bimët e kultivuara dhe ruhet vegjetacioni vendas;
- Përmirësohet cilësia e frutave, perimeve, farave, fibrave bimore, vajrave esenciale dhe produkteve të tjera të natyrës;
- Sigurohet ruajtja e biodiversitetit të natyrës dhe jetës në ekosistem;
- Mbron, pasuron dhe përmirëson ekosistemet pyjore dhe bujqësore;
- Me anë të pjalmimit të kryqëzuar, krijon pasardhës që kombinojnë tiparet trashëgimore të dy prindërve, me variacion gjenetik, përshtatje më të mirë, mbijetesë dhe forcimin e rezistencës së bimëve ndaj armiqve dhe sëmundjeve;
- Nëpërmjet pjalmimit që kryen, përmirëson pjellorinë dhe mbrojtjen e tokës;
- Na ofron produkte natyrale unike me vlera të larta ushqyese me veprim terapeutik që kontribuojnë në shëndetin tone;
- Na mëson nëpërmjet shoqërisë së saj, organizimit, altruizmit, shpirtit të ekipit dhe përpjekjes së vazhdueshme për mbijetesën e së tërës;
- Pa të, mbijetesa dhe jeta e njeriut do të ishte pothuajse e pamundur;

Aktualisht kemi rreth 12 000 bletërritës në të gjithë vendin, prej të cilëve rreth 2 100 kanë mbi 50 koshere. Pothuajse në çdo qark (përveç Fierit dhe Gjirokastrës), kemi të ngritura dhe funksionale Shoqatat Lokale të Bletërritësve. Brenda muajit prill çdo qark do të jetë i mbuluar me shoqata. Të gjitha Shoqatat Lokale të Bletërritësve janë të grupuara nën Federatën Kombëtare të Bletërritësve të Shqipërisë.

Sipas të dhënave përqëndrimi më i madh i zgjojeve është në qarkun e Shkodrës me rreth 60 mijë koshere, ndjekur nga qarku i Korçës me rreth 51 mijë koshere, e më pas Kukës, Tiranë, etj.,

Mbështetja e sektorit ka qenë e vazhdueshme, përmes masave kombëtare, me rreth 1 0000 lekë/koshere. Mbështetja e dhënë ka qenë në varësi dhe të fondit që MBZHR ka pasur në dispozicion.

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Problemi është mungesa e bazës ligjore të veçantë për bletarinë, rëndësia e sektorit, harmonizimi i legjislacionit me BE-në.

Disa nga shkaqet kryesore të problemit janë:

- Mangësitë në legjislacion;
- Mosplotësim i kushteve të prodhimit dhe tregtimit të produktit;

Grupet e interesit të prekura nga ky problem janë: Qeveria (MBZHR, AKVMB, AKU, AREB)/biznesi (operatorët e biznesit, bletarët profesionistë, Shoqatat e Bletërritësve në nivel lokal, Federata Kombëtare të Bletërritësve)/qytetarët (konsumatorët).

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Identifikoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të trajtuar problemin.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Ndërhyrja nëpërmjet hartimit të ligjit “Për bletarinë” është i nevojshëm, për arsye të formalizimit të sektorit, kërkesës së vazhdueshme të shoqatave të bletërritësve, plotësimit të kushteve të cilësisë së produkteve të bletës, si dhe mbrojtjes së konsumatorit si rezultat i gjurmueshmërisë së produkteve të bletës, me qëllim zbatimirekomandimeve, të BE-së, raport progres, për përafrim të legjislacionit lidhur me Organizimin e Tregut të Përbashkët (CMO)

Kjo ndërhyrje lidhet me objektivin e Qeverisë së Shqipërisë, për rritje të konkurrueshmërisë së produkteve, rritje të cilësisë, të eksporteve, drejt përmbushjes së kriterëve për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, duke synuar përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar me atë të Bashkimit Evropian, të paraqitur në nivel kombëtar në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian.

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Politika e propozuar synon realizimin e objektivave si më poshtë:

- Përcaktimi i rregullave për prodhimin, regjistrimin, transportin, riprodhimin, mbrojtjen, etiketimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve të Bletarisë, si dhe për kontrollin e cilësisë dhe gjurmueshmërinë e produkteve në një periudhë..... X vjeçare.
- Hartimi i Programit për Bashkërendimin e Aktiviteteve për Sektorin e Bletarisë, në bashkëpunim me Shoqatat e Bujqësisë, Shoqatat e Bletërritësve në nivel lokal dhe Federatën e Bletërritësve në nivel kombëtar.
- Mbështetja e Sektorit të Bletarisë në funksion të promovimit dhe mbrojtjes së produkteve shqiptare të bletarisë si dhe nxitja e proceseve të gjurmueshmërisë sipas legjislacionit përkatës për mbrojtjen e mjaltit shqiptar.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë zgjedhur opsionet e renditura.*

Gjatë analizës së kryer, janë shqyrtuar dy opsionet:

- Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re, nuk do të hartohet ligji për rregullimin e këtyre çështjeve. Mos ndërhyrja dhe ruajtja e status quo-së, do të çojë në mos zgjidhjen e probleme të hasura dhe përkeqësim të situatës.
- Opsioni 1: Hartimi i një ligji “Për bletarinë”, për të mundësuar rregullimin ligjor të kësaj veprimtarie. Ky opsion është pranuar si opsioni më i përshtatshëm, më i plotësuar dhe më i zbatueshëm, pasi mungesa e kuadrit ligjor për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për prodhimin, regjistrimin, transportin, riprodhimin, mbrojtjen, etiketimin, përpunimin dhe ruajtjen e produkteve të bletarisë si dhe boshllëku institucional, nuk ofron mjedisin e domosdoshëm për njohjen e bletarisë si veprimtari me interes kombëtar, të dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni se kush preket.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

Për ndikimet e drejtpërdrejta:

- o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- o *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- o *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
- o *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:

- o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- o *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Diskutoni kufizimin e analizës.

- o *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- o *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
- o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

- o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- o *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*
- *Identifikoni se kush preket.*

Për efekt të këtij vlerësimi të ndikimit dhe në mungesë të politikës, ne supozojmë se veprimtaria e bletarisë në Republikën e Shqipërisë nuk do të menaxhohen si duhet, nuk do të ketë një sistem cilësor të kontrollit, si dhe nuk do të merren masat e duhura për garantimin e saj, në rast se nuk kryejmë ndërhyrjet e duhura ligjore.

Opsioni 1, i propozuar për hartimin e ligjit prek grupet e mëposhtme:

- Qeverinë;
 - Biznesin (Bletarët);
 - Konsumatorët.
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur; bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*

Për ndikimet e drejtpërdrejta:

- o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
- o *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
- o *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (shih aneksin 1/a për tabelën që mund të përdorni).*
- o *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.*

Ndikimet ekonomike:

Ky propozim nuk do të sjellë rritje të fondeve shtesë nga buxheti i shtetit.

Kostot e drejtpërdrejta për sektorin publik, Nuk identifikohen kosto që ngarkojnë buxhetin e shtetit.

Strukturapërgjegjëse, për zbatimin e këtij projektligji, do të jetë pjesë e stafit të ministrit. Përcaktimi i këtij funksioni do të bëhet nga ministri dhe mund të jetë një sektor/grup pune/etj.

Ndikimet mjedisore:

Bletaria si veprimtari me interes kombëtar është e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë në përgjithësi dhe synon garantimin e pjalmimit natyror. Meqenëse

bletët pjalmojnë mbi 80% të bimëve të lulëzuara të tokës, duke përfshirë pothuajse të gjitha frutat dhe perimet, duhet të ndërmerren hapa për të rritur ndërgjegjësimin për nevojën për të mbrojtur bletë pasi rënia e tyre mund të ketë një ndikim të paparashikueshëm në ekosistem.

Ndikimet sociale:

Nëpërmjet këtij projektligji si mbështetje për bletarinë, parashikohen stimuj për të rinjtë, për t'u vendosur dhe qëndruar në sektorin e bletarisë si dhe sigurimin e mbështetjes për bletërritësit që operojnë në zona malore ose në zona të pafavorizuara.

- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - o *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - o *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*

Ndikimet ekonomike:

Ndikime jo të drejtpërdrejta ekonomike, janë pa vlerë monetare të drejtpërdrejta në buxhet dhe konsistojnë në rritjen e përgjegjësisë së subjekteve që zhvillojnë aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të produkteve të bletarisë si rezultat i kontrollit gjatë të gjithë zinxhirit ushqimor, pasi një ushqim i sigurt garanton një jetë të shëndetshme, e rjedhë shpenzimet për kujdesin shëndetësor do të reduktohen.

Ndikimet sociale:

Ndikime jo të drejtpërdrejta sociale do të ketë edhe tek konsumatori për produkte bletarie më të sigurta, më cilësore dhe shkallë më të lartë gjurmueshmërie.

Diskutoni kufizimin e analizës:

- o *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
- o *Tregoni sa të forta, të pavarura dhe të rëndësishme janë provat që mbështesin supozimet.*
- o *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*

Rritja dhe fuqizimi i veprimtarisë së bletarisë në vendit tonë, mund të kërkojë që të ketë një numër më të madh të punonjësve që kryejnë kontrollin zyrtar të tyre. Kontrolli zyrtar kryhet gjithmonë nga institucione shtetërore buxhetore, pasi është një kompetencë e cila nuk delegohet dhe si e tillë ka varësi nga buxheti i shtetit. Risku që vjen nga kjo varësi është i ulët, pasi do ketë përparësinë të lidhur me shëndetin e konsumatorit.

Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:

- o *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
- o *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
- o *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (shih aneksin 1/b për tabelën që mund të përdorni).*

Opsionet e vlerësuara nga grupi teknik i punës u kryen duke analizuar situatën aktuale, ku rezultojmë me mungesë kuadri ligjor për rregullimin e kësaj veprimtarie, si dhe në përputhje me rregulloret e BE-së, Nr. 1308/2013

Në përfundim u arrit në konkluzionin që paraqitja e projektaktit të jetë në formën e projektligjit “Për Bletarinë”.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*
- *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

Opsioni i preferuar është hartimi i një ligji “Për bletarinë”, për të mundësuar rregullimin ligjor të kësaj veprimtarie, bazuar në analizën me shumë kritere.

Opsionet që merren në konsideratë janë:

- Opsioni 0 (*status quo*): Nuk do të ndërhyjmë me ndryshim apo politikë të re;
- Opsioni 1: Hartimi i një ligji “Për bletarinë”.

Për të vlerësuar opsionet duke përdorur analizën me shumë kritere, janë ndjekur hapat e mëposhtme:

1. **Përcaktimi i kritereve që tregojnë arritjen e objektivit**, për të garantuar njohjen e bletarisë si veprimtari me interes kombëtar, e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë:

Efektiviteti në realizimin 100% të planit për rregullimin ligjor të veprimtarisë së Bletarisë

Efektiviteti i lehtësimit të punës së bletërritësve;

Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të akteve nënligjore;

Aftësia gjykuese në masat administrative të marra;

Shkalla e riskut (e ulur);

Kostot.

2. **Vendosja e peshës së kritereve sipas rëndësisë relative**

- Efektiviteti në realizimin 100% të planit për rregullimin ligjor të veprimtarisë së Bletarisë : 5;
- Efektiviteti i lehtësimit të punës së bletarëve : 3;
- Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të akteve nënligjore : 4;
- Aftësia gjykuese në masat e administrative të marra: 2;
- Shkalla e riskut (e ulur) 6;
- Kostot: 5.

3. Përcaktimi i **shkallës së performancës** nëpërmjet intervalit të pikëve nga 0 – 6.

4. **Vendosja e pikëve të opsioneve** përkundrejt secilit kriter sipas matricës së mëposhtme.

Matrica e performancës:

Kriteret	Pesha (Rëndësia relative)	Opsioni 0		Opsioni 1	
		Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)	Pikë	Vlera (=Pesha x pikë)
Efektiviteti në realizimin 100% të planit për rregullimin ligjor të veprimtarisë së Bletarisë	5	0	0	3	15
Efektiviteti i lehtësimit të punës së bletarëve	3	2	6	5	15
Efektiviteti i hartimit dhe zbatimit të akteve nënligjore	4	1	4	2	8
Aftësia gjykuese në masat e administrative të marra	5	0	0	1	5
Shkalla e riskut (e ulur)	6	1	6	6	36
Kostot	2	2	4	4	8
Pikët totale për secilin opsion			20		87

Analiza me shumë kriteret tregon se opsioni 1 (hartimi i ligjit “Për bletarinë”, është vlerësuar me më shumë pikë dhe ne e kemi zgjedhur atë si opsionin tonë të preferuar.

Ky opsion përmbush realizimin e të gjitha objektivave të parashikuara.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila njësi do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*
- *Specifikoni të gjitha kërkesat e përputhshmërisë dhe të zbatimit.*

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, struktura përgjegjëse për bletarinë në MBZHR së bashku me Autoritetin Kombëtar i Ushqimit, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, si dhe shoqatat lokale të bletërritësve, janë institucionet përgjegjëse për monitorimin e zbatueshmërisë së tij, pas miratimit të këtij propozimi.

Pengesa e mundshme që mund të haset është forcimi i kapaciteteve kryesisht në kryerjen e detyrave, nëpërmjet trajnimeve me kostot përkatëse.

Gjatë zbatimit të projektligjit të propozuar, për të arritur qëllimet e politikës, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Plotësimi me akte nënligjore i ligjit, që lidhet me përcaktimin e vendndodhjes, sipërfaqes kullosore, kapacitetit mjaltëdhënës, pas një studimi, regjistrin, bletarinë urbane, programin për mbrojtjen e mjedisit.
- Forcimi i kontrollit të produkteve të bletarisë që prodhohen në vend.
- Rritja e kapaciteteve të stafit inspektues, nëpërmjet përcaktimit të një programi të qartë trajnimi.
- Fushata ndërgjegjësimi për biznesin, (bletarët profesionistë, Shoqatat Lokale të Bletërritësve, Federata Kombëtare të Bletërritjes) si dhe konsumatorët.

Faza e shqyrtimit/vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.*

Propozimi i këtij projektligji përmban elementë të rëndësishëm, për zbatimin e planit të punës, për sistemin e monitorimit dhe vlerësimit në zbatimin e ligjit, bazuar në problemet e konstatuara.

Indikatorët për të matur arritjen e objektivave janë si më poshtë:

- Numri i bletërritësve të regjistruar në shoqatat lokale;
- Numri i zgjojeve;

Numri i bletërritësve përfitues nga skemat kombëtare

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuara në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin – një herë										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Kosto për biznesin – një herë										
Kosto për biznesin – në vazhdim										
Kosto për grupet e tjera – një herë										
Kosto për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto në total										
Kosto e zbritur në total = Kosto në total x faktorin zbritës										

Përfitimi për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi për biznesin – një herë										
Përfitimi për biznesin – në vazhdim										
Përfitimi për grupet e tjera – njëherë										
Përfitimi për grupet e tjera – në vazhdim										
Kosto për buxhetin – në vazhdim										
Përfitimi në total										
Përfitimi i zbritur në total = Përfitimi në total x faktorin zbritës										
Vlera aktuale e koston në total										
Vlera aktuale e përfitimit në total										
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e koston në total										

Raporti i ndikimit të vlerësimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1			
Opsioni 2			